



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Prezenca në Shqipëri**

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT BERND BORCHARDT,  
NË TRYEZËN TEKNIKE TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME DHE  
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR ZBATIMIN E LIGJIT TË  
DEKRIMINALIZIMIT**

*Tiranë, 12 mars 2019*

E nderuar Prokurore e Përgjithshme, i nderuar Kryetar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të nderuar partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, të nderuar miq!

Është një kënaqësi e veçantë për mua që gjendem sot këtu në nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit mes institucioneve tuaja, në kuadër të zgjedhjeve vendore të 30 qershorit. Ky është një hap shumë pozitiv përpara në bashkëpunimin mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Ai krijon bazën e nevojshme për një luftë më të efektshme ndaj manipulimeve zgjedhore, si dhe për një pastrim më efektiv të listave të kandidatëve nga shkelësit e ligjit apo nga personat që po hetohen penalisht.

Ne e kemi përkrahur që nga fillimi një marrëveshje të tillë dhe gjatë ditës së sotme kolegët që po marrin pjesë në këtë veprimtari, pra, specialistë e fushës, do të diskutojnë se si ta vënë atë në zbatim më së miri.

Si Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu edhe Prokurorisë së Përgjithshme, ligji iu beson detyrën për pastrimin e listave zgjedhore nga personat, që për shkak të precedentëve penalë, nuk kanë integritetin e nevojshëm për të ushtruar funksione publike dhe për të garantojnë besimin e publikut në funksionimin e organeve shtetërore, sikurse Kuvendi e të tjerë, në një moment kritik për Shqipërinë.

Është vërtet detyrë e vështirë, dhe jam shumë i vetëdijshëm për këtë, detyrë e cila rëndohet nga prania e disa dispozitave ligjore të paqarta që kërkojnë interpretim dhe vendimmarrje të shpejtë, veçanërisht tani që nuk mbetet edhe shumë kohë, sepse vetëm pak muaj na ndajnë nga zgjedhjet vendore të qershorit. Po ashtu, pas disa muajsh progresi të gjithmbarshëm për hartimin e ndryshimeve të legjislacionit zgjedhor, sipas dhe në bazë të rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, ato nuk u votuan nga Kuvendi fatkeqësisht.

Prapë se prapë, jam i sigurt se profesionalizmi dhe pavarësia e organeve tuaja do të bëjë që të bini dakord për çështjet e rëndësishme dhe të ecni përpara.

Mendoj se Shqipëria ka edhe më nevojë për hapa të tillë përpara sot, kur akuzat politike për integritetin e zgjedhjeve minojnë besimin e publikut, si dhe njollosin procesin demokratik dhe pengojnë funksionimin e duhur të institucioneve.

Nxis fuqimisht pjesëmarrësit në tryezën e sotme që përqendrohet në dekriminalizimin e listave zgjedhore, të zhvillojnë diskutime të hapura, praktike dhe me synim arritjen e

rezultateve, në bazë të praktikave më të mira dhe përvojës së gjerë që secili nga ju ka rreth kësaj teme.

Sikurse theksohet në raportin e OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017, autoritetet shqiptare duhet të trajtojnë me përparësi problemin e vazhdueshëm të akuzave të përhapura për shitblerje votash, të cilat kanë cenuar besimin e publikut në zgjedhje. Dhe kjo këto janë fjalë të forta. Nevojiten përpjekje serioze nga të gjitha palët për të trajtuar këtë fenomen. Ndjekja penale efikase është një nga mjetet kryesore për luftën ndaj shitblerjes së votës. Për këtë qëllim ndihmon edhe bashkëpunimi më i mirë me KQZ-në. Memorandumi i sotëm për Bashkëpunim dhe diskutimet në lidhje me implementimin e tij sa më të efektshëm përbëjnë një pikënisje të shkëlqyer për këtë qëllim.

Një rekomandim tjetër i OSBE/ODIHR-it, të cilin dëshiroj ta kujtoj këtu, është që autoritetet shqiptare duhet të hetojnë të gjitha ankesat për abuzime me burimet shtetërore dhe për presione të lidhura me punësimin përgjatë procesit zgjedhor: këto janë veprime të rëndësishme që ju duhet t'i ndërmerrni sa herë të jetë e nevojshme, pa u vonuar.

Po ashtu, raporti i OSBE/ODIHR-it rekomandon ngritjen e një organi gjithëpërfshirës, të pavarur dhe transparent për mbikëqyrjen e institucioneve shtetërore, përdorimin e burimeve shtetërore dhe për presione të lidhura me punësimin.

Ne jemi duke monitoruar nëse çështjet e shkeljeve zgjedhore që denoncohen në Prokurorinë e Përgjithshme ndiqen deri në fund apo jo. Gjithashtu, presim me padurim të shohim rezultate konkrete si rrjedhojë e bashkëpunimit mes dy institucioneve tuaja.

Pa dyshim që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri mbetet e gatshme t'ju mbështesë në përpjekjet tuaja për zbatimin e këtyre rekomandimeve.